



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 1881/16 Prot.

Tiranë, më 14.09.2021

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 69, datë 14.09.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Kombi Invest" Shpk për keqinformim për qëllime kualifikimi, në procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Rajonal Fier", të zhvilluar nga Spitali Rajonal Fier, (në vijim "AK").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Kombi Invest" Shpk, me NIPT K43407402P me adresë: Bishanak, Fier.

I. Arsytet e fillimit të procedimit adminstrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Kombi Invest" Shpk, ka nisur nga kërkesa e shoqërisë "Devis" Shpk, e cila ka kërkuar nga APP, përjashtimin e operatorit ekonomik "Kombi Invest" Shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit me objekt: "Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në Spitalin Rajonal Fier" të zhvilluar nga AK, në datë 06.01.2020.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP, në të cilin pëcaktohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve,që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 69, datë 14.09.2021, APP ka vendosur të përjashtojë për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj operatorin ekonomik "Kombi Invest" Shpk me NIPT K43407402P nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si

rrethanë lehtësuese faktin që, operatori ekonomik “Kombi Invest” Shpk, nuk ka qënë i përjashtuar më parë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, ka keqinformuar pra nuk ka ndërhyrë në dokumenta, përqindjen e ulët të pjesëmarrjes në bashkimin e operatorëve ekonomikë të sipërcituar, (“Kombi Invest” 25%, dhe “Alfa Cleaning” 75%).

Ndërkohë, si rrethanë rënduese mbahet në konsideratë fakti se, operatori ekonomik “Kombi Invest” Shpk është shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi dhe ka nënshkruar kontratën, si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, duke përfituar fonde publike nëpërmjet keqinformimit.